



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 687 / prot.
1

Tiranë, më 22.6.2020

Lënda: *Opinion në lidhje me kërkesën për vënien në dispozicion të dosjeve të depozituara në Kuvendin e Shqipërisë nga Avokati i Popullit për 27 kandidatët e zgjedhur në institucionet e rivlerësimit*

AVOKATIT TË POPULLIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 687 prot., datë 11.06.2020.

Sikurse është parashtruar edhe në shkresën nr. 2059/1 prot., datë 08.01.2020, dërguar Avokatit të Popullit, Zyra e Komisionerit, që në fillim të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për organet e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i ka kushtuar rëndësi të veçantë transparencës në këtë proces, duke e vlerësuar si një qasje të domosdoshme nga secili institucion i përfshirë, me qëllim garantimin e një rezultati përfundimtar në përputhje me pritshmëritë e publikut nga kjo reformë.

Në këtë këndvështrim, kërkesa për informacion lidhur me dosjet e 27 kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, duhet parë dhe interpretuar në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që kanë të bëjnë me sistemin e rivlerësimit. Konkretisht neni 179/b i Kushtetutës përcakton se sistemi i rivlerësimit ngrihet në qëllim që të garantohet shteti i së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut në institucionet e këtij sistemi.

Neni C i Aneksit të Kushtetutës, i cili rregullon posaçërisht veprimtarinë e institucioneve të rivlerësimit, parashikon se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të çliruar nga korrupsioni.

Në këndvështrimin tonë, ushtrimi me përgjegjësi dhe përmbushja e tre parimeve të cituara në dispozitën e sipërpërmendur i shtrin efektet e saj që me përmbushjen e kritereve të

përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbajtjen e pozicionit të anëtarit të institucioneve të rivlerësimit.

Nga ana tjetër, Neni A i Aneksit të Kushtetutës, duke pasur parasysh impaktin dhe interesin e lartë publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi, përcakton se kryerja e procesit të rivlerësimit, i cili përbën thelbin e kësaj reforme, imponon disa kufizime të të drejtave themelore të parashikuara në Kushtetutë, pjesë e të cilave është edhe respektimi i të drejtës së privatësisë. Me një interpretim të gjerë të këtij Neni, pjesë e procesit të rivlerësimit është dhe ngritja e funksionimi i organeve të rivlerësimit, dhe kufizimi i të drejtave themelore kushtetuese si ajo e privatësisë, zbatohet dhe mbi anëtarët e tyre.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, duke qenë se Autoriteti Publik deklaroi se disponon dosjet për 27 kandidatët e zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, ky dokumentacion në parim përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe për pasojë duhet t’i vihet në dispozicion kërkuarit.

Pavarësisht sa më sipër, Autoriteti Publik duhet të bëjë paraprakisht vlerësimin e dokumentave që përmban dosja dhe nëse konstatohen të dhëna personale, publikimi i të cilave nuk i shërben interesit publik dhe do të cënonte sferën e privatësisë së kandidatëve, apo publikimi i të cilave do të ishte në tejkalim të parimit të mjaftueshmërisë të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dosja në fjalë mund të vihet në dispozicion të kërkuarit duke anonimizuar pjesët që kufizohen, në përputhje me nenin 17, pika 6 e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Sugjerojmë, që e njëjta praktikë të ndiqet edhe në raste të ngjashme nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, për çdo kërkesë të depozituar në lidhje me dosjet e kandidatëve të zgjedhur në procesin e rivlerësimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

